



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

KUMTESË PËR MEDIA
24 PRILL 2018

RrGK e shqetësuar me vendimin e Presidentit për njërin nga rastet e falura

Me datë 23 prill, Presidenti i Republikës së Kosovës Z. Hashim Thaqi shfrytëzoi të drejtën për falje nga mbajtja e denimit të burgut, e drejtë kjo në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Falje.

Në mesin e të falurve, Presidenti ka falur edhe një të njohur të tij, respektivisht, dhëndrrin e axhës së tij, i cili në vitin 2008 kishte kryer 2 vrasje. Në mesin e të vrarëve ishte vajza e tij 15 vjeçe dhe kusheriri i tyre i moshës 21 vjeç, sipas [Gazetës Online Insajder](#).

Ligji për Falje i Republikës së Kosovës, në Nenin 5, thotë se *“rrethanat që mund të shqyrtohen gjatë dhënies së faljes përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: peshën e krimin; rrezikun e recidivizmit; pendimin e sinqertë; dhe shfaqjen e sjelljeve dhe karakterit të respektueshëm”*. Bazuar në këtë, Rrjeti i Grave të Kosovës, ngrit shqetësimin në lidhje me atë se cilat kritere janë marrë për bazë në rast të faljes nga mbajtja e denimit të burgut të këtij personi. Në mediat lokale, thuhet se pas denimit fillestar prej 6 muajsh, me rastin e vrasjes së vajzës së tij, i njejt, është liruar, dhe po atë ditë, ai kishte ushtruar edhe vrasjen e dytë. Më këtë rast, nuk është dëshmuar se ka shenja të pendimit të sinqertë, dhe po i njejt mund të konsiderohet si rrezik për recidivizëm, bazuar në të kaluar e tij.

Tutje, fakti që Presidenti dhe i faluri, kanë lidhje familjare, poashtu paraqet një shqetësim për RrGK-në, pasi që ky mund të jetë një mesazh dekurajues për të burgosurit dhe të burgosurat por edhe për të gjithë shoqërinë.

Rrjeti i Grave të Kosovës beson në dhënien e mundësive të secilit individ që të përparojë, të rehabilitohet dhe të marrë trajtimin e duhur, në përputhje me ligjet në vend. RrGK e konsideron pozitiv faktin që qytetarëve dhe qytetareve që kanë kryer ndonjë vepër penale, tu jepet mundësia e faljes nga mbajtja e denimit të burgut, ashtu siç parasheh Kushtetuta dhe Ligji për Faljen. Mirëpo, edhe në këto raste, duhet të jemi të vëmendshëm se cilat raste po i falim, dhe çfarë mesazhi po i dërgojmë shoqërisë me këto falje.

Në të kaluar, RrGK ka vizituar Institucionet Korrektuese, ku ka parë raste të grave të cilat në vetmbrojtje kanë vrarë anëtarë të familjes. Edhe pse ka pas raste dhe fakte për torturat që këto gra i kanë përjetuar ndër vite si pasojë e dhunës në familje ndaj tyre, ky fakt nuk është marrë parasysh si rrethanë lehtësuese nga ana e gjyqësorit dhe po këto gra janë denuar për vrasje në vetmbrojtje me burgim deri në 30 vite.

Andaj jemi të shqetësuar se në këtë rast, falja e ushtruar si e drejtë e Presidentit nuk ka respektuar institucionin e faljes si institucion i përkufizuar sipas ligjit të Kosovës.